



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Nr./Br. 011/A1-3557
Data/Datum 09.02.2020
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

Kuvendi i Komunës - Gjakovë
01 Nr. /2020
Dt. 30.01.2020

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së pa Luajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2020 pas diskutimit lidhur me pikën e 9 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale-vendosjen e panove reklamuese, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale, vendosjen e panove reklamuese në pjesët e parcelave sipas listës së pronave për të cilat është nxjerrë vendimi paraprak, me këtë përbërje :

1. z. Arben Bakalli, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
2. z. Durim Halilaj, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
3. znj. Teuta Pallaska, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës .
4. z. Ali Tafarshiku, përfaqësues i Kuvendit të Komunës .
5. znj. Dorina Lluka, përfaqësuese i sektorit jo qeveritar .

2. Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi që ti zhvilloj procedurat e parapara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së paluajtshme Komunale vetëm për pronat e cekura në pikën 1 të këtij vendimi, për të cilat është nxjerrë vendimi paraprak nga Kuvendi i Komunës.

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës

4. Vendimi iu dërgohet:
- Kryetarit të Komunës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Anëtarëve të Komisionit
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës .
 - Arkivit,

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Anton Shala